



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS KAMENICË

Numri i lëndës: 2019:154124

Datë: 02.05.2024

Numri i dokumentit: 05645849

C. nr. 102/2017

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN - DEGA NË KAMENICË, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, përmes gjyqtarit Artan Abazi, në çështjen juridike kontestimore të paditësit N. H. nga, të cilin me autorizim e përfaqëson Refik Basha, avokat nga Kamenica, kundër të paditurive T. D. T. D., B. L., B. L., H. L. dhe V. L. që të gjithë nga, me objekt kontesti për vërtetimin e të drejtës së pronësisë, me vlerë të kontestit prej 1,500.00 euro, jashtë seancës gjyqësore, më datën 29.04.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

I. HEDHET POSHTË padia e paditësit N. H. nga f....., me numër C. nr. 102/2017, e datës 07.06.2017, e parashtruar kundër të paditurve T. D., T. D., B. L., B. L., H. L. dhe V. L. që të gjithë nga, , për vërtetimin e të drejtës së pronësisë, me vlerë të kontestit prej 1,500.00 euro.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës.

A r s y e t i m

Paditësi N. H ngacilën me autorizim e përfaqëson Refik Basha, avokat nga Kamenica, më datën 07.06.2017, në këtë gjykatë ka paraqitur padi kundër të paditurve T. D., T. D., B. L., B. L., H. L. dhe V. L. që të gjithë nga me objekt kontesti për vërtetimin e të drejtës së pronësisë, me vlerë të kontestit prej 1.500.00 euro.

Gjykata, duke e pasur parasysh që të paditurve T. D., T.D., B. L., B. L., H. L. dhe V. L. që të gjithë nganuk ka qenë e mundur t'u gjindet adresa e saktë e vendbanimit apo vendqëndrimit, edhe pas kërkesave prej institucioneve relevante, me propozimin e të autorizuarit të palës paditëse, me aktvendim C.nr. 102/2017, të datës 04.04.2024, e ka aprovuar propozimin për caktimin e përfaqësuesit të përkohshëm, për të vepruar në emër të të paditurve T. D., T.D., B. L., B. L., H. L. dhe V. L., që të gjithë nga

Po ashtu, gjykata përmes Aktvendimit C. nr. 102/2017, të datës 04.04.2024, e ka urdhëruar paditësin N. H.nga, përmes të autorizuarit të tij, avokatit Refik Basha, që në afat prej dhjetë (10) ditësh, pas ditës së pranimit të aktvendimit të lartëcekur, t'a bëjë deponimin në xhirollogarinë – arkën e kësaj gjykate, të shumës prej 1,527.00 euro, në emër të paradhënies për shpërblimin e punës të përfaqësuesit të përkohshëm. Përveq kësaj gjykata përmes aktvendimit të lartëcekur, e ka njoftuar paditësin dhe të autorizuarin e tij, që nëse nuk e kryen detyrimin e përcaktuar për pagesën e shumës së lartëcekur në emër të paradhënies për shpërblimin e punës së përfaqësuesit të përkohshëm, do të konsiderohet se ka hequr dorë nga propozimi për caktimin e përfaqësuesit të përkohshëm, e rrjedhimisht do të konsiderohet se e ka tërhequr padinë.

Ndërsa, i autorizuari i palës paditëse, avokati Refik Basha nga Kamenica, përmes parashtreses së dorëzuar në këtë gjykatë më datë 19.04.2024, e ka njoftuar gjykatën se pala paditëse nuk po mundet t'i siguroj parat që duhet t'i paguaj si paradhënie në emër të përfaqësuesit të përkohshëm, i cili do të vepronte në emër të të paditurve, por që ka kërkuar nga gjykata që të komunikoj më Odën e Avokatëve të Kosovës, për ta caktuar një përfaqësues të përkohshëm, për të paditurit, në mënyrën PRO BONO.

Gjykata, pas pranimit të parashtresës së lartëcekur e ka analizuar të njëjtën dhe ka ardh në përfundim se një propozim i tillë i bërë nga i autorizuari i palës paditëse është në kundërshtim me dispozitat e LPK-së, respektivisht nuk është detyrë e gjykatës që të gjej, kërkoj dhe të angazhoj avokat PRO BONO, për palët e paditura për të vepruar në emër të të paditurve si përfaqësues i përkohshëm, ngase në rastet e tilla gjykata ka rol pasiv dhe kjo është detyrë ekskluzive e palës paditëse që t'i përmbush detyrimet konform neneve 79 dhe 81 të LPK-së dhe të paguaj paradhënie për caktimin e përfaqësuesit të përkohshëm. Për më tepër i autorizuari i palës paditëse, respektivisht paditësi, nuk i ka ofruar gjykatës asnjë dëshmi të vetme se i njëjti nuk ka mundësi financiare që ta paguj paradhënien në emër të caktimit të përfaqësuesit të përkohshëm, i cili do të vepronte në emër të të paditurve, e duke i pasur parasysh të gjitha të lartëcekurat, pretendimet dhe kërkesën e të autorizuarit të palës paditëse gjykata nuk e mori për bazë, ngase këto pretendime janë të pa bazuara dhe aspak të argumentuara me prova konkrete, madje kërkesa që gjykata të aktivizohet që në emër të palës paditëse, t'a caktoj një përfaqësues të përkohshëm është tërësisht në kundërshtim me dispozitat ligjore të LPK-së, sepse gjykata është e obliguar vetëm ti zbatoj dispozitat ligjore për caktimin e përfaqësuesit të përkohshëm dhe nuk e ka për obligim që të bëjë asnjë veprim tjetër përtej zbatimit të këtyre dispozitave ligjore.

Andaj, Gjykata duke e pasur parasysh faktin se paditësi, respektivisht i autorizuari i tij avokati Refik Basha, përmes aktvendimit të lartëcekur, më datën 04.04.2024, ka qenë i njoftuar dhe i detyruar, për t'a deponuar në xhirollogarinë - arkën e kësaj gjykate, shumën e lartëcekur në emër të shpërblimit të punës të përfaqësuesit të përkohshëm, dhe i njëjti deri në datën e sotme kur edhe është nxjerrur ky aktvendim, nuk e ka paguar shumën e lartëcekur dhe gjykatës nuk i ka ofruar prova për deponimin e kësaj shumë në xhirollogarinë - arkën e kësaj gjykate, nga dita kur paditësi e ka pranuar obligimin e lartëcekur përmes së cilit e ka pasur për detyrim që t'a deponoj shumën prej 1,527.00 euro, si paradhënie në emër të shpërblimit të punës së

përfaqësuesit të përkohshëm, ndërsa në anën tjetër i njëjti këtë detyrim është dashur që t'a përmbush brenda afatit prej dhjetë (10) ditësh, pas ditës së pranimit të detyrimit të lartëcekur, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Duke i pasur parasysh të lartëcekurat e duke u bazuar në dispoziten e nenit 81 paragrafi 2 të LPK-së, ku përcaktohet se “*Në rastet nga paragrafi 2, i nenit 79 të këtij Ligji, i padituri ka për detyrë të deponoj shumën e të hollave, për pagimin e shpenzimeve të përfaqësuesit të përkohshëm, kurse në rastet nga paragrafi 3 i të njëjtit nen, shpenzimet i deponon paditësi*”, e lidhur me dispoziten e nenit 391 paragrafi 1, pika g) të LPK-së, ku përcaktohet se Gjykata e hedh poshtë padinë nëse “*.....paditësi brenda afatit të caktuar nga gjykata nuk i ka hequr mungesat nga neni 79 dhe 102 të këtij ligji*”, gjykata erdhi në përfundim se paditësi nuk e ka përmbushur detyrimin e tij brenda afatit të caktuar nga gjykata nga dita kur ka qenë i njoftuar për detyrimin e tij dhe vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Nga të lartëcekurat, e duke u bazuar në dispoziten e nenit 79, 81 paragrafi 2, 391, pika g) dhe 387 paragrafi 1, pika q), u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN – DEGA NË KAMENICË
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil
C. nr. 102/2017, i datës 29.04.2024

G j y q t a r i
Artan Abazi, d. v

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi mund të ushtrohet ankesë në Gjykatën e Apelit të Kosovës, në Prishtinë, në afat prej 15 ditësh, pas ditës së pranimit të të njëjtit, nëpërmjet kësaj gjykate.

Numri i lëndës: 2019:154124
Datë: 02.05.2024
Numri i dokumentit: 05645849